

01-559



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
 Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-54588/22 dt. 11.03.2022, të Qendrës Klinike Spitalore në Prishtinë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shëndetësorë-spitalore ”Spitali për shërbime gjithpërfshirëse pediatrike dhe kirurgjike” me etazhitet P+3ET dhe nga ndërtesat përcjellëse me etazhitet P+0ET dhe B+P, ndërtuar në kuadër të kompleksit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 24.03.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Qendrës Klinike Spitalore në Prishtinë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-54588/22 dt. 11.03.2022, përdorimi i ndërtesës shëndetësore-spitalore “Spitali për shërbime gjithpërfshirëse pediatrike dhe kirurgjike” me etazhitet P+3ET dhe ndërtesat përcjellëse me etazhitet P+0ET dhe B+P të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “A1/2-0” të tërësisë “A” të Planit Rregullues Prishtina e Re –Zona Perëndim sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-0112219/17 dt. 21.07.2017, në kuadër të kompleksit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë konkretisht në një pjesë të parcelës kadastrale nr. 2805-1, ZK Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në kuadër të kompleksit Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Poseduesi i Lejes, Qendra Klinike Spitalore në Prishtinë dhe Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosoves, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-54588/22 dt. 11.03.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shëndetësore-spitalore “Spitali për shërbime gjithpërfshirëse pediatrike dhe kirurgjike” me etazhitet P+3ET dhe ndërtesat përcjellëse me etazhitet

Prishtina e Re –Zona Perëndim, konkretisht në një pjesë të parcelës kadastrale nr. 2805-1, ZK Prishtinë, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351/02-0112219/17 dt. 21.07.2017, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare Njoftim mbi Inspektimin Final, me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-2189/22 dt. 09.03.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimin Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Xhevat Gorçaj; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Alush Shala; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësllësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Zarife Sallahu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Petrit Hajrizi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Bekim Dobraj; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Bekim Dobraj, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar Afrim Bytyçi me nr. të licencës 1.

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësllësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.


Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-54588/22 DT. 24.03.2021**

Zyrtari,
Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtori,
Arben Sadiki



